



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 3364/prot
3

Tiranë, më 06 . 7 .2018

URDHËR

Nr. 435 , datë 06 . 7 .2018

“PËR

MOS RIPËRTËRITJEN E LICENCËS AGJENCISË “AMP” SI AGJENCI E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE”

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, udhëzimit nr. 5166, datë 20.10.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; si dhe kërkesës së agjencisë “AMP” për ripërtëritje të licencës me nr. 3364, datë 7.5.2018, Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 205, datë 4.4.2018 “Për ngritjen e grupit të punës, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për licencim /ripërtëritjen e tyre në fushat e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ndryshuar me Urdhrin nr. 228, datë 17.4.2018 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 205, datë 4.4.2018”, si dhe legjislacionin në fuqi “Për Organizatat Jo-fitimprurëse”;

KONSTATOVA:

- a. Gjatë shqyrtimit të dosjes së agjencisë AMP, agjenci e administrimit kolektiv në fushën e drejtave të prodhuesve të fonogrameve, rezulton mungesa e kontratave të reciprocitetit, si detyrim që buron nga ligji nr. 35/2016, ku përcaktohet si element specifik dhe kryesor për agjencitë e administrimit kolektiv, konkretisht, neni 135 dhe neni 137, si dhe Udhëzimi nr. 5166, datë 20.10.2016 i Ministrit të Kulturës “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr.35/2016, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

- b. Pas verifikimeve të kryera pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për secilin anëtar të kësaj agjencie, si dhe në zbatim të nenit 159 pika c) dhe e) të ligjit nr. 35/2016, rezultojnë se anëtarët e kësaj agjencie, bazuar të drejtave që agjencia përfaqëson, konkretisht si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të producentëve, një pjesë e tyre nuk gëzojnë statusin për të qenë prodhues fonogrami, si dhe përfitues të shpërblimeve që agjencia mbledh në emër dhe për llogari të tyre.
- c. Rezulton se një prej anëtarëve të AMP-së është në konflikt interesi e parashikuar në ligjin nr .9367, datë 7.4.2005 me drejtuesin e agjencisë AMP dhe në shkelje të nenit 133/2/ii të ligjit nr. 35/2016, ku dispozitat statutore të agjencive të administrimit kolektiv duhet të marrin parasysh parimin e transparencës, parimin e konfliktit të interesit në organet e tyre drejtuese, si dhe parimin e mosdiskriminimit midis anëtarëve, anëtarëve dhe joanëtarëve, si dhe midis përdoruesve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të. Rezulton se drejtuesi i AMP është njëkohësisht edhe ortak i subjektit ALBATRADE PLUS me 50% të kuotave, fakt ky i verifikueshëm në ekstraktin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- d. Bazuar kritereve që përcakton udhëzimi nr. 5166, datë 20.10.2016, ka mungesa në dokumentacionin mbi kualifikimin dhe formimin e punonjësve që agjencia ka të kontraktuar në pozicionin jurist /ekonomist/ financier, apo trajnime të kryera në fushën e të drejtave të autorit.

URDHËROJ:

1. Mos ripërtëritjen e licencës së Agjencisë “AMP”, si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogrameve.
2. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
3. Kundër këtij urdhri, kërkuesi ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Mirela KUMBARO FURXHI

